

AA

Vjetar informativ i
Departamentit të Antropologjisë
Fakulteti Filozofik,
Universiteti i Prishtinës
"Hasan Prishtina"
Shtator 2022 / Nr. 4



Letra e redaksisë

Të nderuar lexues,

Ky është numri i katërt i vjetarit informativ të Departamentit të Antropologjisë, në të cilin do të gjeni informata rreth ngjarjeve të ndryshme që kanë ndodhur gjatë vitit akademik në kuadër të punës së Departamentit të Antropologjisë. Ka pasur hulumtime arkeologjike, punë etnografike në terren, seminare, botime e shumë ngjarje të cilat janë organizuar nga stafi dhe studentët e Departamentit.

Një lajm fantastik është fakti se një numër i studentëve të Departamentit kanë vazhduar studimet në universitete evropiane, disa me bursa të plota. Nga ana tjetër, marrëveshjet e bashkëpunimit të Departamentit të Antropologjisë me institucione të ndryshme, kanë hapur mundësi të shumta për punë praktike për studentët. Ndër to marrëveshja me BKK, CHWB, 7 Arte, MKRS-në e institucionet e tjera. Departamenti ka vazhduar traditën e ligjëruesve vizitorë, si atyre të ftuar nga profesorët, ashtu edhe të atyre të ftuar përmes programit ERASMUS. Këtë vit, edhe profesorët tanë kanë ligjëruar jashtë vendit në ligjërata mysafire.

Këtu do të gjeni informata për punën e palodhur të stafit akademik dhe studentëve tanë të cilët mendimet dhe idetë e tyre i kanë kthyer në punë të vlefshme praktike dhe studimore. Përmes ligjëratave mysafire, pjesëmarrjes së stafit në konferenca e seminare të ndryshme, botimit të vazhdueshëm, gërmimeve arkeologjike, realizimit të projekteve të ndryshme, Departamenti i Antropologjisë ka arritur ta ngris në një nivel shumë më të lartë fushën e antropologjisë dhe arkeologjisë në Kosovë.

Po ashtu Departamenti i Antropologjisë ka përgatitur programin e ri studimor “Antropologji dhe trashëgimi kulturore” i cili tashmë ka kaluar të gjitha filtrat dhe do të dorëzohet për akreditim, që të fillojë si program i ri që gërsheton antropologjinë kulturore dhe arkeologjinë në kontekst të studimit të trashëgimisë kulturore.

Një ndër lajmet e fundit është sukcesi që stafi dhe studentët tanë në bashkëpunim me arkeologët e huaj kanë arritur për gjatë gërmimeve në Ulpianën antike, për të cilën do keni rast të lexoni në faqet në vazhdim.

Po ashtu, nuk duhet harruar edhe projektet e mëdha nacionale që stafi dhe studentët e antropologjisë kulturore kanë realizuar dhe po realizojnë në mbledhjen e kujtesës kolektive të Kosovës, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” dhe institucionet tjera vendore e ndërkombëtare.

Si redaktore të këtij edicioni të Vjetarit AA, ndihemi të lumtura që kemi mundur të përmbledhim një pjesë të madhe të punës së departamentit tonë, për të njoftuar të gjithë studentët potencialë, por edhe opinionin e gjerë, se sa shumë punohet në Departamentin e Antropologjisë, për studimin e kulturës, shoqërisë dhe trashëgimisë kulturore.

AA, Nr. 4, Shtator, 2022

Vjetar informativ i Departamentit të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Redaksia: Rilinda Gjonbalaj (rilinda.gjonbalaj@studenti.uni-pr.edu) dhe Miridonë Sylja (miridone.sylja@studenti.uni-pr.edu)

Del njëherë në vit, në formë të shtypur dhe digjitale.

Ballina © Ilir Culaj, 2022 - uebfaqja: <http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamentio9.aspx>



INFO & AKTIVITETE

Doracaku për studentë

Edhe këtë vit, Departamenti i Antropologjisë ofron “Doracakun e Antropologjisë”, një përmbledhje e përgjigjeve ndaj shumë pyetjeve që studentët potencialë dhe ata ekzistues i kanë rreth studimeve antropologjike dhe aktiviteteve edukative e kërkimore që realizohen nga Departamenti i Antropologjisë.

Për ta zbardhur doracakun në formë digjitale, shkoni te vegza:

<http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti09.aspx>

**DORACAK PËR STUDENTË
2022-2023**

**Departamenti i Antropologjisë
Fakulteti Filozofik**



Antropologji dhe trashëgimi kulturore



Gjatë dy viteve të fundit, Departamenti i Antropologjisë ka realizuar disa takime pune, për të diskutuar për riakreditimin e programit BA. Duke u bazuar mbi hulumtimet e fundit në terren, por edhe zhvillimet e fundit në UP dhe sistemin e arsimit të lartë në Kosovë, anëtarët e Departamentit kanë ardhur në përfundim që të akreditojnë programin e ri, “*Antropologji dhe trashëgimi kulturore*”, si një mishërim mes dy fushave të antropologjisë (arkeologjisë dhe antropologjisë kulturore).

Grupi i profesorëve dhe asistentëve ka analizuar programe të ngjashme në vende të tjera, ka analizuar edhe tregun vendor dhe ka bërë konsultime edhe me studentët e Departamentit, si ata që janë duke studiuar si ata që veçse e kanë kryer studimin.

Ky program do të ofrojë mundësi që studentët e ardhshëm të fokusohen në studimin antropologjik në përgjithësi dhe studimin antropologjik të trashëgimisë kulturore në veçanti. Programi synohet të akreditohet gjatë vitit 2022-2023, për t’u ofruar për studentët e parë në tetor të vitit 2023.

20 vjet studime antropologjike në UP

Arsim Canolli

Në tetor të vitit 2021 u festua 20 vjetori i hapjes së Departamentit të Antropologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Fillimisht, në vitin 2001, ky Departament u themelua si Departamenti i Etnologjisë, por më 2014 u riemërua si Departament i Antropologjisë, me dy drejtime: antropologji kulturore dhe arkeologji. Departamenti i Antropologjisë është i vetmi Departament i Antropologjisë në gjuhën shqipe në Kosovë e Shqipëri me profile specifike BA “Antropologji kulturore” dhe “Arkeologji” në kuadër të katër fushave të antropologjisë: antropologjisë kulturore, arkeologjisë, antropologjisë fizike dhe antropologjisë linguistike. Si i tillë është institucion me vlerë unike për studimet albanologjike!

Në vitin 2014, me iniciativën e prof. Edi Shukriut e prof. Arben Hajdarit, u themelua edhe dega e arkeologjisë. Plot 8 vite studime arkeologjike në degën e arkeologjisë në UP, degë prej së cilës kanë dalur dhjetëra studentë të diplomuar, të cilët ndjekin studimet postdiplomike në universitetet më të mira evropiane, MA dhe PHD. Një sërë profesorësh e kolegësh nga shumë institucione duhet falënderuar, si nga Kosova e Shqipëria ashtu edhe nga Franca e vendet e tjera. Një meritë të veçantë kanë tre profesorët e arkeologjisë nga Akademia e Studimeve Albanologjike, prof. Luan Përzhita, prof. Belisa Muka e prof. Evalda Paci, të cilët kanë qenë me ne prej fillimit.

Në fjalën e saj të rastit, prof. Drita Halimi-Statovci, njëherish edhe nismëtare për themelimin e Departamentit në vitin 2001, theksoi: “Më mungojnë fjalët për të shprehur



se sa i gëzohem suksesit të kësaj natyre dhe sa emocione kam për këtë Departament.” Ajo falënderoi të gjithë që kanë kontribuar në këtë drejtim, profesorët e departamenteve të tjera në Fakultetin Filozofik dhe gjithë stafin kontribues e studentët e këtij departamenti.

Departamenti falënderon edhe për studiuesit e profesorët e vendeve të ndryshme që kanë marrë pjesë në Seminarin e Antropologjisë (2018 -), një seminar që vazhdon me ligjërata mujore. Pa dyshim se duhet falënderuar studentët e të gjitha gjeneratave që kanë diplomuar dhe ende vazhdojnë të bashkëpunojnë me Departamentin.

Falënderim i veçantë shkon edhe për familjet e ndryshme në terren anekënd Kosovës që pranojnë të jenë bashkëbisedues me ne për jetën e tyre të përditshme, falënderojmë organizatorët e festivaleve folklorike, drejtorët e stafin e muzeve të ndryshme, artizanët e zejtarët,

organizatat joqeveritare, mediat e ndryshme, institucionet e tjera kulturore, universitetet partnere dhe gjithë bashkëpunëtorët e tjerë.

Falënderojmë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahjen e madhe ndër vite për studentët tanë si në punë praktike, ashtu në bursa e projekte, falënderojmë Ambasadën Amerikane dhe Ambasadën e Francës në Kosovë për përkrahjen e vazhdueshme në projekte e bursat për studentët tanë.

Prej vitit të ardhshëm Departamenti nuk do të regjistorjë studentë në drejtimin arkeologji, por synon të ofrojë një program të ri studimor “BA Antropologji dhe trashëgimi kulturore”. Në një vend të vogël si Kosova, të kemi një Departament të Antropologjisë për 20 vjet rresht është sukses që duhet t’i gëzohemi të gjithë.

Muzeu i gjërave

Tringa Sefedini, studente e antropologjisë kulturore

Koncepti i muzeut të gjërave të humbura lindi në një detyrë 20 minutëshe në klasën e lëndës “Muzetë dhe ekspozimi i kulturës”. Liria dhe hapësira kreative që na u dha mundësoi që ky projekt të jetësohet brenda objektit të Universitetit. Idea e muzeut ngritet rreth pyetjes - ku shkojnë gjërat pasi që humbin? E përcjellur nga kjo pyetje, në katin e parë të Fakultetit Filozofik u krijua një hapësirë imagjinare ku u grumbulluan gjërat që zakonisht na humbin. Vizitorët mund të kalonin nëpër atë hapësirë dhe të shikonin gjërat e humbura. Hapësira përbante kuletë, pasaportë, çelësa, fotografi, lodra fëmijësh etj...

Por, të gjitha këto janë vetëm objekte fizike, të prekshme, dhe ato nuk peshojnë shumë në krahasim me humbjet tona emocionale dhe ekzistenciale. Humbjet metafizike të ndjenjave tona nuk vërehen nga askush. Ato janë të fshehura në thellësi të brendshmërisë sonë. Muzeu i gjërave të humbura krijoi një hapësirë ku këto humbje dalin jashtë nesh dhe ndahen/bashkëndjehen me të tjerët. Qëllimi i muzeut ishte të krijonte një *relational aesthetic* (estetikë ndërlidhëse - term i krijuar nga kuratori Nicolas Bourriaud në vitet e 90-ta). Kjo formë e kurimit mundëson të bërit art duke u bazuar në marrëdhëniet njerëzore dhe kontekstin e tyre shoqëror. Arti relacional është mjet i krijimit të rrethanave shoqërore ku përvoja e vizitorit në mjedisin e krijuar bëhet art në vetvete. Detyra ime ishte vetëm që të kanalizoj këto përvojë sociale – humbjen. Përderisa Fakulteti Filozofik i mungon një hapësirë ku studentët mund ta shfrytëzojnë për të ngritur kualitetin





dhe kreativitetin e studimit - realizimi i idesë u bë më sfidues.

Me ndihmën e profesoreshës Zanita Halimi dhe studentëve Enis Bytyqi dhe Rilinda Gjonbalaj, ky problem filloi të zbutej dhe u përdor salla për studime sociale (e cila është e mbushur me kompjuterë). Për qëllime estetike, e gjithë salla u mbulua me qese të bardha, duke krijuar kështu një hapësirë më ëndërrimtare dhe të pazakontë. Funksioni i kësaj dhome ishte të krijonte një ambient të qetë dhe stimulues për vizitorin. Në mes të hapësirës u vizualizuan dhe u vendosën tre emocionet

të humbura

më të forta njerëzore: zemërimi, vuajtja dhe dashuria.

Të përcjellur nga një muzikë *white noise* (zhurmë e bardhë), vizitorët bënin ecje rrethore mes hapësirës duke kaluar nëpër emocionet e vendosura në qendër. Kur ecja e shkurtër përfundonte, vizitorët gjendeshin përball një table në të cilën mund të shkruanin dhe të ngjitnin humbjet e përjetuara. Anash tabelës u vendosën 2 copa letre. Në njërin letër vizitorët mund të shkruanin për humbjen e tyre, e më pas ta vendosin atë në tabelë. Kurse, në letrën tjetër ata mund të shkruanin po të njëjtën humbje dhe ta merrnin me vete për ta vendosur në një vend të sigurtë me qëllim që të mos e humbasin më kurrë. Tabela u përdor si bazë e të dhënave të humbjeve emocionale shpirtërore. Në fillim të ekspozitës tabela ishte pothuajse e zbrazët. Në të shkruhej se dikush e kishte humbur



oreksin, dëshirat dhe ëndërrat, e po ashtu edhe vullnetin për t'i përfunduar provimet.

Me kohë, korridorin me objektet e humbura dhe hapësira ku përshkruante brendshmërinë tonë emocionale u mbush me vizitorë. Kishte persona që nguronin të shkruanin, disa mendoheshin dhe ktheheshin prapë, kurse të tjerë e dinin menjëherë se çfarë kishin humbur dhe merrnin letrën me vete me qëllim që kur të dalin nga muzeu/ekspozita të shkonin në kërkim për ta gjetur prapë. Pas përfundimit të ekspozitës u afrova tek tabela e humbjeve metafizike. Aty, përball meje u shfaq një botë personale dhe intime mes personash. Pjesëmarrësit kishin humbur dashurinë, identitetin, ndjenjën për të qenë lozonjarë, vullnetin për të humbur peshë, përqaftimin e babait, qelizat trupore, vullnetin për jetë, lodrën e fëmijërisë... e dikush edhe sallën e profesorit Pleurat!

Gjatë kohës sa isha duke lexuar për këto humbje kisha shtresime emocionale dhe shpresoja se muzeu ia kishte arritur qëllimit – njerëzit t'i gjenin prapë humbjet e tyre. Në fund fare, kur u hoq instalimi dhe gjithçka dukej çfarë s'kishte qenë më parë, brenda mureve të Fakultetit mbetën vetëm përjetimet dhe emocionet e krijuara. E kjo më mbushi me idenë se Fakulteti nuk është një vend vetëm për të shkruar e përfunduar studimet. Aty mund të ndeshen përjetime të forta, të bëhen studime dhe ndërmarrje kreative dhe të plotësuar. Tek e fundja, vetë retrospektiva e Universitetit të Prishtinës na e dëshmon këtë.

Ulpiana (Justiniana Secunda) – hulumtimet e reja

Ilir Culaj

E lokalizuar rreth 12 km në jug-lindje të Prishtinës, Ulpiana antike është një nga qendrat më të rëndësishme arkeologjike në Kosovë dhe rajon. E kthyer tashmë në një Park Arkeologjik, ajo vazhdon të shërbejë si një destinacion i rëndësishëm për promovimin e trashëgimisë kulturore, por edhe si vend i cili pret arkeologë dhe specialistë të disiplinave të arkeologjise për të hulumtuar dhe shpalosur historinë e saj publikut.

Nën udhëheqjen e Arben Hajdarit (UP), Christophe Goddard-it (ENS) dhe Milot Berishës (IAK), në kuadër të projektit arkeologjik nga Ulpiana në Justiniana Secunda 2022-2024, financuar nga Bashkimi Europian në kuadër të fondeve IPA II, gjatë këtij viti pati zbulime të rëndësishme të cilat hedhin dritë mbi aspekte të ndryshme të këtij qyteti antik. Zbulimet e këtij viti, plotësuan mozaikun e të dhënave tona mbi organizimin e qytetit dhe transformimet që ka njohur Ulpiana përgjatë shekujve.

Pjesëmarrës në këtë projekt ishin një numër i madh ekspertësh europian, në veçanti ata nga Franca, Italia dhe Britania, respektivisht kolegët nga École Normale Supérieure (Paris) dhe La Sapienza (Romë). Po ashtu, pjesë e kësaj ekipe ishin edhe ish-studentët dhe studentë të Departamentit të Antropologjisë : Elena Rexha, Tringa Berbatovci, Blerta Abazi, Shkurte Gashi dhe Drilona Berisha, pjesa me e madhe e të cilëve vazhdojnë studimet në PhD dhe Master në ENS dhe Université Lymier Lyon 2.

Falë metodave gjeofizike të



realizuara përgjatë dy viteve paraprapke, është arritur të identifikohet një numër i madh i strukturave dhe objekteve brenda mureve rrethuese të qytetit. Këto vrojtme, u shtrinë edhe në pjesën që në literaturën arkeologjike është konsideruar si zona e kampit ushtarak (castrum). Mirëpo, siç duket, këtu kemi të bëjmë me qytetin Justiniana Secunda, që me urdhër të perandorit Justiniani I, u ndërtua pothuajse ngjitur me Ulpianën, pasi që kjo e fundit u godit nga një tërmet shkatërrues në vitin 518.

Duke u bazuar pikërisht në hulumtimet e sipër-përmendura, këtë vit, gërmimi u koncentrua brenda Justiniana Secunda, ku dhe u zbulua një kishë me përmasa të jashtëzakonshme, rreth 80m gjatësi me 24m gjerësi. Gërmimet u përqendruan tek pjesa lindore e kishës, ndërsa në anën veriore dhe jugore u zbuluan themelet e mureve limituese, të cilat përcaktuan gjerësinë e saktë të këtij objekti. Kemi të bëjmë me një kishë tri anijatëshe, ku pjesa

qendrore përbëhet nga një dysheme me mozaik polikrom, kurse dy anët tjera kanë dysheme me pllaka argjilore. Përgjatë gërmimit doli në pah një material i konsiderueshëm arkeologjik, i cili pastaj u analizua nga ekspertët përkatës dhe shërben si një orientues i mirë për datim.

Në mënyrë që të ndriçohet sa më shumë historiku dhe kronologjia e këtij vendbanimi, gërmimet arkeologjike do të vazhdojnë edhe përgjatë viteve në vijim. Profesorët e Departamentit të Antropologjisë së bashku me studentët, do jenë përsëri pjesë e këtyre ekspeditave për të dhënë kontributin e tyre në punët dhe sfidat që vazhdon t'i ketë arkeologjia në Kosovë.

Rrëfe për mos me harrue!

35 studentë e ish-studentë të antropologjisë kulturore dhe shkencave të tjera sociale nga UP kanë realizuar 202 intervista me të mbijetuarit e masakrës së Krushës së Madhe të 25-27 marsit 1999. Ky projekt është në fazën e transkriptimit dhe përkthimit të tyre në gjuhën angleze. Projekti është menaxhuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” dhe realizuar nga Departamenti i Antropologjisë dhe studentët e tij. Mentorë të projektit janë profesorët Arsim Canolli, Tahir Latifi dhe Shemsi Krasniqi.

Valentina Krasniqi, studente e antropologjisë kulturore (2022)

Arditë Aliu, studente e antropologjisë kulturore (2022)

“Rrëfe për mos me harrue” është motoja e projektit “Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarëve të Masakrës së Krushës së Madhe”. Qëllimi kryesor i këtij projekti është nxjerrja në pah e dëshmimeve të heshtura rreth masakrës së 25-27 marsit të vitit 1999 në Krushë të Madhe të komunës së Rahovecit. Mizoritë e kësaj masakre që la pas vetes 241 të vrarë, civilë të paarmatosur, dhe 64 të zhdukur për fatin e të cilëve nuk dihet gjë, në mënyrë institucionale nuk janë dokumentuar asnjëherë. Kështu për herë të parë, pas 21 viteve, Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” në bashkëpunim me Departamentin e Antropologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” kanë realizuar 202 intervista të historisë gojore (audio dhe video) me të mbijetuarit dhe dëshmitarët okularë të masakrës. Synim i përbashkët yni ka qenë dokumentimi, publikimi dhe ruajtja e rrëfimeve të të mbijetuarëve.

Pjesëmarrja në këtë projekt vërtetë ka qenë e vështirë dhe sfiduese. Mirëpo nga këshillat e fituara prej mentorëve të projektit, padyshim që na u lehtësua puna në terren. Përpos që na përgatitën profesionalisht duke realizuar trajnime të shumta që



nga fillimi i projektit, shpeshherë edhe na qëndruan pranë gjatë tërë ditës së terrenit. Në mesin e 30-të hulumtuesëve, ne ishim më të rejtat në moshë. Vajzat e lindura pas luftës këtë rradhë po dëgjonin përjetimet tronditëse të njerzëve ndoshta për periudhën më të keqe të tyre. Por, na lumturon fakti që të gjithë të intervistuarit kanë shprehur gatishmërinë të ndajnë rrëfimin e tyre me ne. Besimi i tyre se gjeneratat e reja po përpiqen të nxjerrin n’dritë fakte të luftës na ka dhënë vullnet për të vazhduar

misionin tonë.

Secila intervistë ka qenë e mbushur me plot emocione e shpesh të përcjellura me lot. E si mund të mos qaje me Xhevdetin që tregonte se si forcat serbe ia kishin djegur babain apo me rrëfimin e zonjës Gonxhe që tregonte për keqtrajtimin e bërë gjatë kohës së masakrës! Përvoja që kemi krijuar përmes këtij projekti është jashtëzakonisht dobiprurëse. Ky projekt vazhdimisht po na hapë rrugët për të qenë pjesë e përvojave të reja. Për të qenë të sinqerta, projekti na ka mësuar shumë për hjekat, mbijetesën, dhimbjen. Me një fjalë na ka rritur shumë shpirtërisht.

Për ne është ndjenjë tejet e veçantë të jemi pjesë e këtij projekti me vlerë të madhe. Tani brezat e rinjë do të mund të informohen në mënyrë të plotë për të vërtetat e masakrës. Le ta ketë ky projekt këmbën e mbarë për shumë të tjerë që do vijjnë pas.

Falenderojmë të gjithë ata që kanë qenë pjesë e ruajtimit tonë, por ne duhet të cekim se një vend të veçantë në zemrën tonë, tashmë e kanë zënë banorët krushianë me mikpritjen e treguar ndaj nesh.

Kujtesa e Plavës dhe Gusionë

Rilinda Gjonbalaj, studente e antropologjisë kulturore

Gjatë këti viti kemi realizuar projektin “Kujtesa e Plavës dhe Gusionë: rrëfimet e 20 pleqve dhe plakave nga krahina e Plavës dhe Gusionë”, projekt ky i cili është realizuar nën mentorimin e prof. Arsim Canollit dhe me përkrahjen e MKRS, dhe, së shpejti, presim të aprovohet edhe botimi nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”.

Fillimisht dua të shpreh se sa e lumtur dhe krenare ndihem që kam arritur të përmbledh një punë të tillë, një studim i cili ka rëndësi të madhe në historinë gojore shqipëtare, sepse është i pari i llojit të vet që realizohet në rajonin e Malësisë së Madhe. Gjithmonë kemi lexuar dhe mësuar për veten nga të tjerët. Këtë herë do të mësojmë nga ata që i kanë jetuar ato ngjarje.

Përzgjedhja e pleqëve dhe plakave nuk ka qenë e rastësishme; të intervistuarit i takojnë moshës 70-94 vjeçare, të dy gjinive dhe me profesione të ndryshme, që nga amviset deri te ish-deputetët në ish-Jugosllavi. Po ashtu, të intervistuarit janë shqiptarë të besimit katolik dhe atij islam, që vijnë nga të gjitha fshatrat shqiptare të krahinës së Plavës dhe Gusionë. Duhet thënë se ndër ta ka edhe individë që dikur kanë migruar e më pas përsëri i janë kthyer atdheut. Por, kemi intervistuar edhe individë që e ndiejnë veten shqiptarë, por pothuajse e kanë humbur gjuhën shqipe.

Pyetjet që u janë drejtuar të



intervistuarve janë përzgjedhur me shumë kujdes, pjesa më e madhe e tyre janë të njëjta, në mënyrë që ta kemi pasqyrën reale të kohës dhe të shohim këndvështrimin e secilit për të njëjtat ngjarje, ku vërehet se si kujtojnë ata që ka qenë funksionarë të shtetit dhe ata ka qenë të përndjekur nga shteti.

Në intervista kemi mbledhur rrëfime nga ngjarjet historike, politike dhe kulturore, duke vënë në pah çdo sferë të jetës që të intervistuarit e kanë jetuar. Kujdesje e veçantë i është kushtuar bashkjetesës së shqiptarëve mes veti të cilët e kanë ndarë të njëjtin fshat dhe tokë, por kanë qenë të besimeve të ndryshme, problemeve ndëretnike, marrëdhënieve me pushtetin, rrëfimeve popullore, ngjarjeve historike, dasmave, riteve të vdekjes, bjeshkës, rendit dhe organizimit të jetës.

Secili ka shprehur atë se si ata i kanë përjetuar ato ngjarje, kanë krahasuar kohën ku ne jetojmë

dhe të kaluarën, sa kemi ndryshuar si popull, sa kemi arritur të mbajmë gjallë traditat dhe kulturën tonë, sa po arrijmë t'i përcjellim tek brezat e rinj dhe ndryshimin mes gjeneratave.

Intervistimi është zhvilluar në atë mënyrë që secili që intervistohet ta ndiej veten komod dhe të rrëfejë pa lënë anash hollësitë. Kjo ka dalë të jetë pak më ndryshe nga metodologjia e zakonshme, sepse kemi punuar me njerëz të moshës së tretë dhe ata janë mjaft të ndjeshëm. Nuk është përdorur as gjuha standarde e as ndonjë kriter i strikt i intervistimit, për vetë faktin se për të arritur tek të dhënat që ne duam është dashur që biseda të jetë sa më familjare. Andaj, intervista është zhvilluar në formë të bashkëbisedimit në dialektin e krahinës së Plavës dhe Gusionë, i tillë do të jetë edhe transkriptimi i cili do të vijë në formën origjinale edhe të të folurit edhe të të shprehurit, sepse konsiderojmë që është një pasuri etnografike dhe leksikore për popullin tonë.

“Kujtesa e Kosovës” ... në Maqedoninë e Veriut

Teutë Ahmeti, studente e arkeologjisë dhe gjuhësisë (MA) në Francë, ENS

Gjatë kohës sa kam qenë studente e antropologjisë në Universitetin e Prishtinës, jam angazhuar si intervistuese/hulumtuese në realizimin e projektit të historisë gojore “Kujtesa e Kosovës: rrëfime të 100 pleqve e plakave të Kosovës”, me ç’rast kemi mbledhur rrëfime nga 100 pleq dhe plaka të Kosovës.

Përvoja në këtë projekt (i cili tashmë është përbushur me sukses) më ka mundësuar që të njihem mjaft mirë me metodologjinë e realizimit të historisë gojore, si dhe të ndërjegjësohem për rëndësinë e saj. Duke i pasur parasysh këto dy rrethana kyçe, natyrshëm më ka lindur interesimi dhe gatishmëria e zgjerimit të këtij hulumtimi edhe jashtë hapësirës së Kosovës, pra në Maqedoninë e Veriut (duke intervistuar pleq shqiptarë).

Ky interesim pa dyshim që ka ardhur edhe nga nxitje të tjera të shumta, por para së gjithash nga nevoja dhe dëshira për t’i njohur rrëfimet edhe të disa pleqve të tjerë nga një territor i ri. Sepse, një plak më shumë do të thotë një variant rrëfimor më shumë, një variant dialektor më shumë, një variant kulturor më shumë. Kështu, vendosa që t’i realizoja një numër intervistash (rreth 30) në Maqedoninë e Veriut, si një lloj zgjatimi i projektit të mëparshëm “Kujtesa e Kosovës”.

Mirëpo, për dallim nga hera e parë, ku puna ishte ekipore, këtë herë hulumtimin iu qasa gati krejt e pavarur, dhe mund të them që kjo formë e punës më dha një lloj lirie dhe sigurie të cilën nuk e kisha pritur. Ky projekt i cili po zhvillohet me shkëputje të herëpashershme (për



shkak të disa obligimeve tjera), ka nisur vitin e kaluar dhe është duke vazhduar akoma. Që në hapat e parë të punës më ka përcjellur përvoja e mëparshme; jam mbështetur në të. Në saje të asaj përvoje kisha vëmendjen që të kujdesesha për disa pika të cilat konsideroja se mund të bëheshin ndryshe nga ç’kisha vepruar me pleqtë e “Kujtesës së Kosovës”. Kështu, mund ta vëreja në mënyrë të dukshme se sillësia me një natyrshmëri të theksuar, që me sa duket vinte nga siguria dhe vetëbesimi që kisha fituar nga eksperiencia paraprake.

Sa i përket mbarëvajtjes së punës, do thënë që në përgjithësi ka qenë e rrjedhshme. Identifikimin e pleqve e kam bërë pa ndonjë problem të madh. Shumëkush më ka kontaktuar, duke më treguar se e ka një të afërm i cili është i gatshëm të rrëfejë. Kurse, takimi me të intervistuarit (pleqtë) gjithmonë është një përjetim më vete.

Të ngrohtë dhe të papërtueshëm në rrëfimet e tyre, ata janë një motiv më shumë për ta vazhduar këtë punë e cila ka nisur mbarë dhe po vazhdon më një ecuri të kënaqshme.

Antropologjia dhe arkitektura


Florina Jerliu & Arsim Canolli

Ligjëratat mysafire të profesorëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Departamentit të Antropologjisë në Fakultetin Filozofik janë bërë tradicionale. Edhe këtë vit akademik, profesori Arsim Canolli dha një ligjëratë mysafire para studentëve të vitit të pestë të arkitekturës, në kuadër të lëndës së “Teoria dhe praktika e restaurimit”, të profesoreshës Florina Jerliu. Tema ishte “trashëgimia kulturore shpirtërore”, por diskutimi u bë në raport me restaurimin e konservimin e objektit arkitekturor. Nga gjithë ligjërata dolën tri fjali, që studentët u pajtuan për t’i sprovuar tutje:

- Sendet nuk kanë shpirt, por ato përshpirtërohen nga shpirti e kreativiteti njerëzor
- Pa interpretim të thukët, s’ka reprezentim të duhur dhe
- Antropologjia është më shkencorja nga dijet humane, më humania nga dijet shkencore – thënie e Eric Wolf-it – që tregon se bashkëpunimi mes arkitektëve dhe antropologëve duhet të jetë frytdhënës.

Profesori Canolli theksoi se trashëgimi kulturore shpirtërore nuk janë vetëm doket, zakonet, zejet e format e shprehjes, por edhe guri, druri, tulla, hekuri, qelqi, të cilat përshpirtërohen nga vetë njeriu, të cilat bëhen mishërim i kreativitetit, kujtesës, historisë, identitetit, etj. Pra, në aspektin qenësor, trashëgimia kulturore bëhet, prandaj duhet të interpretohet se si bëhet, për çfarë arsye, kush e bën atë e me radhë. Antropologjia e trashëgimisë kulturore provon t’i njoh e interpretojë këto gjëra.

Po ashtu, profesoresha Florina Jerliu dha një ligjëratë mysafire për temën e trashëgimisë kulturore në kuadër të



lëndës “Trashëgimia kulturore”, që ligjërohet nga profesor Arsim Canolli, në semestrin V të studimeve në fushën e antropologjisë kulturore. Tema ishte tipologjia e trashëgimisë kulturore, por profesoresha Jerliu hapi diskutimin, që nuk duhet të shterojë kurrë, për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e pasur të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

“Antropologët dhe arkitektët e trashëgimisë kulturore duhet të bashkëpunojnë që përmes njohjes së hollësishme, konservimit të integruar dhe harmonizimit ligjor e të politikave publike, ta ruajmë trashëgiminë kulturore të Kosovës”, tha ajo para studentëve

të antropologjisë.

Gjatë ligjërates ajo gjeti një mori diskrepancash në sistemin e mbrojtjessëtrashëgimisëkulturore të Kosovës, që menaxhohet nga institucione qendrore dhe lokale dhe ofroi modele teorike e praktike të zgjidhjes së shumë prej problemeve që paraqiten në kontekst të konservimit e restaurimit.

Studentët e dy fakulteteve patën mundësi të njihen me pikëpamjet e ndryshme mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si nga antropologjia, ashtu edhe nga studimet arkitekturale.

HERAS+: “Historical demography in Kosovo”

Tahir Latifi

Profesori Tahir Latifi vazhdon hulumtimet në kuadër të projektit: “Historical demography in Kosovo”. Projekti është i mbështetur nga HERAS+ dhe është në bashkëpunim me Universitetin e Graz-it (Austri).

Ky projekt ka për qëllim evidentimin dhe mbledhjen e të dhënave nga statistikat vitale, të dhënat nga regjistrat e administratave shtetërore: dorëshkrime të regjistrimeve të popullsisë, lista tatimore, regjistra të popullsisë; dokumente nga administratat fetare: kishtarë dhe të xhamive – ngjarjet

jetësore, lindjet, martesat, vdekjet, librat për ekonominë familjare etj.

Këto të dhëna janë ndarë në dy prioritete: prioriteti i parë, deri në fund të Luftës së Parë Botërore; prioriteti i dytë, deri në vitin 1941. Deri në verë të vitit 2022, studiuesit e përfshirë në projekt, kanë arritur të mbledhin të dhëna nga disa qendra: Janjevë (Lipjan), Prishtinë, si dhe Komuna e Gjakovës është gati në përfundim.

Nga muaji tetor 2022 vazhdohet me Komunën e Prizrenit, për të vazhduar më pas në Komunën

e Klinës. Projekti ka filluar në qershor 2021 dhe zgjat deri në pranverë të vitit 2023. Partner në implementim të projektit janë: 1) Koordinator: Universiteti i Graz-it – menaxher, Dr. Siegfried Gruber; 2) Universiteti i Prishtinës është partner 1 dhe bashkë-koordinator, me Prof.Ass.Dr. Tahir Latifi dhe si hulumtuese e re/asistente Egzona Azemi, e diplomuar në Departamentin e Antropologjisë; 3) Universiteti i Tiranës, Partner 2, me Dr. Gentiana Kera.

Ri-konceptimi i ekspozitës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Profesor Arsim Canolli mori pjesë në grupin punues të antropologëve/etnologëve në kuadër të punëtorisë treditore për rikonceptimin e muzeut të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që u mbajt më 18-20 mars 2022, në Prizren.

Projekti i “Rikonceptimit të ekspozitës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” ka mandatar kryesor Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, ndërsa menaxhohet nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë e Prizrenit. Grupet punuese, gjatë tre ditëve punë, hartuan një propozim nistor për “termat e referencës” për rekonceptimin e ekspozitës së LSHP-së, duke u fokusuar në aspektin historik, etnologjik dhe kuratorial.

Pritet që projekti i synuar të realizohet në vitin 2028, në 150 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila është ndër ngjarjet më të rëndësishme të kombit modern shqiptar.






Bjeshkë Guri

Bjeshkë Guri është antropologe e diplomuar në Departamentin e Antropologjisë. Bjeshka punon si hulumtuese në organizatën joqeveritare “Iniciativa rinore për të drejtat e njeriut në Kosovë”. Në kuadër të punës së saj ajo ka krijuar “Muzeun Virtual të Refugjatëve”, për të cilin ka punuar dhe në temën e diplomës si antropologe. Këtu ajo rrëfen për përvojën e saj.

“Studimet në Departamentin e Antropologjisë më kanë hapë shumë dritare në perceptimin e rëndësisë së dokumentimit, ruajtjes e shtjellimit të kujtesës kolektive. Përmes ligjëratave, leximeve e projekteve të ndryshme, interesi rreth kujtesës së luftës ka ardhur natyrshëm. Gjatë studimeve jemi trajnuar në vazhdimësi që të bëjmë pyetje të cilat përgjigjet i kanë pasur të rrënjosura thellë në përditshmërinë tonë. Kjo ka zgjuar kuriozitetin si element kyq të mendimit dhe përjetimit antropologjik.”



Rreth 1.5 milion qytetarë të Kosovës janë detyruar t'i braktisin shtëpitë e tyre shkaku i luftës në vitet 1998-99. Muzeu Virtual i Refugjatëve është krijuar për të dokumentuar kujtesën kolektive mbi dëbimin e dhunshëm masiv, që ka ndodhur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ky proces është zhvilluar përmes krijimit të një platforme dixhitale, të populluar me përvoja personale të refugjatëve.

Memorializimi dhe dokumentimi i dëbimit masiv gjatë luftës

është i pakët dhe sporadik. Neglizhimi dhe mungesa e memorializimit të përjetimeve të personave që kanë qenë refugjatë gjatë luftës ka qenë shtysa kryesore e krijimit të platformës dixhitale Muzeu Virtual i Refugjatëve, që përmes intervistave të kryera me anë të metodës së historisë gojore, po krijon një arkivë të kujtesës së luftës.


Kjo platformë është një arkivë e kujtesës që synon të krijojë një paletë me narrativa të shumëllojshme dhe përjetime diverse të luftës, që

E ARDHMJA NISË T'U E NJOFTË T' KALUMEN

sfidojnë dhe shkojnë përtej atyre dominante e glorifikuese.

Muzeu Virtual i Refugjatëve është themeluar nga **Iniciativa rinore për të drejtat e njeriut në Kosovë** (*Youth Initiative for Human Rights Kosovo - YIHR KS*), organizatë jo-qeveritare e cila promovon, mbron dhe avokon për të drejtat e njeriut, proceset e ballafaqimit me të kaluarën, sundimin e ligjit dhe vlerat qytetare si parime fundamentale për një shoqëri të lirë, të përgjegjshme dhe progresive. Procesi i konceptimit dhe ndërtimit të *Muzeu Virtual të Refugjatëve* ka filluar në vitin 2018. Duke qenë pjesë e YIHR më ka mundur që të udhëheqë të gjitha fazat e krijimit të muzeut duke aplikuar kështu metodën etnografike vëzhgim me pjesëmarrje.

Dixhitalizimi si hapësirë alternative, ka mundur që dokumentimi i përvojave të njerëzve, sidomos përmes përdorimit të historisë gojore, të përdoret në masë të madhe. Si iniciativë, praktikohet në shumë vende që qëllimin kryesor e kanë ruajtjen e rrëfimeve, sensibilizimin e audiencës mbi ndodhi specifike e historike dhe qasshmërinë e madhe që teknologjia ofron. Gjatë intervistimit të ish-refugjatëve të luftës është përdorur metoda e historisë gojore. Kjo metodë ka dëshmuar vazhdimisht të mirat e saj në terren, sidomos



kur informantëve i'u është dashur të eksplorojnë trauma që nuk i kanë trajtuar më parë. Në biseda pas intervistave, të intervistuarit janë shprehur të kënaqur me këtë mënyrë të intervistimit pasi që janë ndier të lirë të rrëfejnë në mënyrë më spontane dhe e kanë udhëhequr intervistën varësisht se në çfarë aspektesh kanë dashur të thellohen.

Ajo çfarë kam vërejtur gjatë hulumtimit tim etnografik dhe çka vjen në shprehje përmes intervistave me refugjatë e bisedave me familjarë që kanë humbur familje


e të afërm gjatë luftës e familjarë të personave të pagjetur, është një ndarje dihotomike e kujtesës.

Këtë ndarje e kam cilësuar si kujtesa e refugjatit/es e cila është e shumëllojshme dhe komplekse dhe tjetra, një kujtesë heroike e cila e shperfaqë sentimentin e heroit dhe dëshmorit.

Përmes muzeut ne vazhdojmë të mbledhim përvoja personale të personave që kanë qenë refugjatë, duke ju dhënë kështu hapësirë eksperiencave të padëgjua më parë.”

Prishtinë, Lubjanë, Vjenë

Besjana Rrahmani, ish-studente e antropologjisë kulturore



Pas përfundimit të studimeve Bachelor në Universitetin e Prishtinës, dega Antropologji Kulturore, vendosa të vazhdoj studimet e nivelit Master në po të njëjtin Universitet që përfundova programin e shkëmbimit të programit Erasmus në vitin 2019/2022, në Universitetin e Lubjanës.

Njëra nga arsytet më logjike apo më argumentuese të përzgjedhjes sime për të vazhduar në programin e përbashkët Master Ndërkombëtar Creole *Dallimet Kulturore dhe Proceset Transnacionale*, qëndron për faktin sepse objektivi kryesor i këtij programi ka për qëllim të transmetojë njohuri të standardeve të larta në fushën sociale dhe të antropologjisë kulturore tek studentët e huaj, dhe njëkohësisht të integrojë mësimin e tyre me kërkimin themelor dhe të aplikuar, brenda kornizës kombëtare dhe ndërkombëtare. Diçka që më ka

pëlqyer jashtë mase nga ky program është e ndërlidhur me hapësirën e eksperimentimit të kuadreve të ndryshme antropologjike, për faktin sepse ky program i Masterit Creole është i integruar jo vetëm nga modulet opsionale që i ofron, si përshembull: “Identitetet e reja”, “Kultura materiale dhe konsumi” dhe “Kultura vizuale dhe popullore”, por ky program është i integruar edhe me shkollën verore intensive, si dhe me lektorë vizitues nga departamentet partnere. Gjatë këtij viti akademik kemi mbajtur katër ligjërata nga Universitetet partnere. Dhe, gjithashtu, njëra nga eksperiencat më gjithëpërfshirëse dhe intensive ka qenë vetë shkolla verore apo programi vjetor intensiv. Të gjithë ne studentët e këtij programi të regjistruar nëpër Universitetet e ndryshme si ai i : Lubjanës, Universiteti Spanjoll Autònoma de Barcelona, Universitetin Kombëtar të Irlandës Maynooth, Univeristetin e Vienës, Universitetin Francez Lumiere Lyon II, Universitetin Zvicerran të Bern-it, dhe Universitetin Polak, jemi mbledhur këtë vit, ashtu siç e parasheh dhe programi, për të marrë pjesë aktive në këtë shkollë verore që ka zgjatur rreth dhjetë ditë, dhe për të prezentuar hulumtimet dhe pasqyrën teorike e metodologjike të hulumtimit tonë të ardhshëm të temës së diplomës.

Ky program mund të them ka qenë me të vërtetë gjithëpërfshirës sa i përket aktiviteteve tona. Kemi pasur mundësinë të dëgjojmë ligjërata nga profesorë të ndryshëm të këtyre Universiteteve Partnere,

njëkohësisht edhe të ligjërojmë si studentë, por edhe të të marrim pjesë nëpër vrojtime etnografike dhe puntori të ndryshme.

Kurse sa i përket këtij viti të ri akademik, jam me të vërtetë e lumtur që ky program më ka ofruar mundësinë të vazhdojë studimet e ardhshme në Universitetin e Vjenës. Ky vit 2022/2023 do të jetë ende më intensiv sa i përket kurikulave dhe njohurive të reja. Ka disa ditë që jam njoftuar me Departamentin e Antropologjisë Socio-Kulturore këtu në Vjenë, por gjithashtu edhe me sistemin e databazës që ky Universitet e ofron dhe nivelin e arritshmërisë së tij, dhe deri më tani nuk kam ndonjë ankesë apo koment negativ sa i përket mikpritjes si njëri nga Universitetet partnere.

Për fund do të doja të ndaja me studentët e ardhshëm që kanë ambicie për të vazhduar në nivelin Master të Antropologjisë, disa nga prioritetet dhe të mirat që ky program që kam përzgjedhur, mund të ofroj për të gjithë studentët që dëshirojnë ta marrin parasysh si opsion për të vazhduar studimet e tyre. Ky program, siç edhe kam mundur të vërej, përmirëson njohuritë, kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentët, dhe trajton të diplomuarit e ardhshëm që të performojnë punë kërkimore të pavarur, aplikative dhe zhvillimore, në të njëjtën kohë siguron një terren të mirë për tu regjistruar në studimet e doktoratës brenda Bashkimit Evropian dhe gjetkë në botë. Vazhdimi i studimeve në nivel doktorature pas përfundimit të suksesshëm të programit CREOLE është lehtësuar veçanërisht në vendet e Universiteteve partnere të programit si (Slloveni, si dhe Austri, Francë, Irlandë, Poloni, Zvicërr dhe Spanjë).

Seminari i Antropologjisë

Antropologji e lumit

Arsim Canolli



Në kuadër të Seminarit të Antropologjisë, më 26 maj 2022, u mbajt ligjërata e Prof. Asoc. Dr. Nebi Bardhoshit, drejtor i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit nga Tirana. Ligjërata ““Për ne jeni pushtues”: njerëzit, lumi, shteti” erdhi si një freski në Seminarin e Antropologjisë; një ligjëratë që ofroi një pikëpamje të hulumtimit të ri të Bardhoshit me fokus mbi temën e mbrojtjes së natyrës në Shqipëri. Dr. Bardhoshi dha një pamje të ngjeshur të etnografisë së tij në luginën e lumit Zall-Gjoçaj të Matit, duke theksuar hisedarët e ndryshëm të mbrojtjes, aspektet gjyqësore, protestuesit, banorët dhe pronarët lokalë, kontekstin krahasimtar të Evropës Juglindore e me radhë, duke shpalosur një panoramë të një monografie

potenciale mbi “antropologjinë e lumit”, që mbledh në shqyrtim lloj-lloj vijash interesi, përroje protestash, diga gjykatash, liqenthe kulturash e me radhë.

Bardhoshi foli kryesisht nga thepi i antropologjisë politike në studimin e mbrojtjes së natyrës në një zonë të thellë të Matit të Shqipërisë, por në konverzacion me antropologjinë e mjedisit, ligjit e shtetit. E bukura e gjithë portreti të këtij hulumtimi që u kumtua se është në bërje e sipër, duket të jetë pikërisht “zona e thellë”, që ka konotimet e saj romantike e politike në etnologjinë shqiptare, sepse prej kësaj luginë lumi, aspak monumentale në hartën ambientaliste të Shqipërisë, (ku mbizotëron Vjosa e të tjerë lumenj), del në pah një raport i thellë empirik, e një argument i ngjeshur juridik-politik, që merr

përkujdesin e duhur etnografik e antropologjik. Kjo është bukuria e antropologjisë: etnografia e një lumi të vogël që përshkon disa fshatra të thella bëhet monument i antropologjisë, përshkruar thellësisht nga përvoja empirike dhe dija e konteksti teorik e krahasimtar. Vetëm antropologët e rryer arrijnë të monumentalizojnë këto zona të thella të shoqërisë, të parrehne dielli e të parrehne lapsi, në kontekst të temave të mëdha ballafaquese në shoqëri. Sepse përmes të voglës, të mënjanuares apo edhe banales, del në pah frymëmarrja e të madhes, të qendëruares dhe spektakulares.

Ligjërata u pasua me një sërë pyetjesh e diskutimesh, më të gjata se zakonisht, të cilat mundësuan edhe njohjen specifike me situata të hulumtimit e të pikëpamjeve jo vetëm për rastin në fjalë, por edhe për natyrën e shtetin e pushtetin në përgjithësi.

Arkeo-terren

Ulpiana - gërmimet 2021

Tringa Berbatovci, studente e arkeologjisë



Ulpiana dikur e njohur vetëm si një ëndërr e vendosur në sirtarin e mendimeve të mia e një ditë të kesh mundësinë të shohësh, prekësh e gërmosh nga afër copëzat e qytetërimeve të lashta të fshehura në tokën e pashteruar dardane është një nder dhe privilegj shumë i madh. Si një ndër qendrat më të njohura në antikitet-Ulpiana e vendosur sot vetëm 12 km nga kryeqyteti, përfaqëson një ndër atraksionet më të mëdha arkeologjike e unike në Kosovë por, edhe më gjerë.

Falë bashkëpunimit në mes të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP), École Normale Supérieure-Paris (ENS-PSL) dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës (IAK), kisha mundësinë që si studente të jem pjesë e shkollës arkeologjike të vitit 2021. Ekipi përbëhej nga ekspertë të lëmive dhe fushave të ndryshme të arkeologjisë, gjë që mundësoi

shtrirjen e diapazonit të njohurive tona për sa i përket: qeramikës, arkeobotanikës, epigrafisë, numizmatikës, gjeologjisë, etj., ku u njohëm nga afër edhe me metodat dhe hulumtimet më bashkëkohore të realizimit të gërmimeve. Fokusi i gërmimeve gjatë vitit 2021 ka qenë ndër lidhja në mes të tempullit pagan me portiko që daton në fund të shekullit të II-të dhe bazilikës paleokristiane që daton në periudhën e perandorit Justinianit I (shek.VI), duke arritur kështu në njohjen e transformimeve arkitektonike dhe urbanistike që kanë ndodhur në këto dy periudha të ndryshme kohore.

Gjatë ekspeditës në parkun arkeologjik Ulpiana kisha fatin që të jem pjesë e organizatës për trashëgimi kulturore ‘European Heritage Volunteers (EHV)’, një tjetër bashkëpunimi ky në mes të EHV-Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)-Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

(KKTK) dhe Parkut Arkeologjik Ulpiana (PAU). Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin studentë të apasionuar pas trashëgimisë kulturore nga e gjithë bota, si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca, Anglia, Spanja, Gjermania, Kili, Shqipëria, Greqia, Serbia, etj., dhe natyrisht pjesëmarrës nga Departamenti i Antropologjisë – UP. Trajnimi me ekspert nga Maqedonia e Veriut kishte për qëllim konservimin e mozaikut romak në Ulpianë, respektivisht mozaikun e termes apo banjës romake që i përket fundit të shek. III dhe fillimi i shek. IV. Përgjatë pesëmbëdhjetë ditëve së bashku me studentët e huaj, arritëm të shkëmbejmë e njihim pjesë nga kulturat tona, të kuptonim se sa të ngjashëm e të ndryshëm jemi por, në fund arritëm të takohemi në një pikë të përbashkët e që padyshim si asnjë tjetër ishte trashëgimia kulturore.

Eksperiencia me ekipin francez dhe studentët nga e gjithë bota në lokalitetin arkeologjik të Ulpianës ka qenë një ndër më të veçantat që kam kaluar në terren, sepse Ulpiana është lokaliteti arkeologjik me potencial të jashtëzakonshëm në formimin tim si arkeologe në të ardhmen. Burim i pashtershëm arkeologjik, që mbartë në vetvete një “oqean” të pafund të kulturës materiale e shpirtërore.



Arkeo-terren

Blerta Abazi, studente e arkeologjisë



të bëjmë me një zonë industriale që ishte përdorur për prodhim dhe shtitje të mallrave të ndryshme.

Krejt në fund, dua të theksoj faktin që pjesëmarrja në një projekt të rëndësishëm siç është ky i Ulpianës, në të cilën të jepet mundësia të punosh me material të periudhave të ndryshme ka ndikuar shumë në përcaktimin tim se ku dëshiroj t'i thelloj studimet e mia në nivelin master.

Tani kam marrë bursë nga Ambasada Franceze për të vazhduar studimet MA në Universitetin Lyon II, në Francë.

Gjatë vitit 2021, pata fatin që të jem pjesë, për rreth një muaj, në projektin ‘Ulpiana 2021; gërmime Arkeologjike dhe hulumtime ndër-disciplinare’, projekt ky nga Instituti Arkeologjik i Kosovës në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe École Normale Supérieure nga Parisi.

Gjatë kohës së angazhuar në Parkun Arkeologjik Ulpiana, kam pasur rastin të punoj me ekspert të ndryshëm, duke u marrë me punët gërmuese/dokumentuese. Po ashtu, jam angazhuar në pjesën teknike të procesit të regjistrimit të gjetjeve dhe mbledhjes së materialit të zbuluar arkeologjik. Jam marr me vizatimin dhe paraqitjen e situatave arkeologjike në kuadrate, planimetri e profile të ndryshme si dhe të strukturave të zbuluara in situ por edhe të skicimit të materialit

të luajtshëm. Gjatë fazes së parë të punës, gërmimet u koncentruan kryesisht tek zona e tempullit pagan, që gjendet jo shumë larg Portës Veriore të Qytetit. Specifikisht, gërmimi u fokusua tek ana jugore e podiumit të tempullit, duke vazhduar deri tek muret e bazilikes kishtarë që gjendej vetëm pak metra larg, në mënyrë që të kuptonimin më shumë rreth ndryshimeve urbanistike të qytetit. Materiali arkeologjik i gjetur në këtë zone gërmimi ishte mjaft interesant, po ashtu, krijonte mundësi për interpretime të reja historike.

Faza e dytë e gërmimeve u zhvillua vetëm pak metra larg Portës Veriore të Qytetit, por kësaj here jashtë mureve rrethuese. Qëllimi ishte që të identifikoheshin më mire hapësirat që gjendeshin mes Portës Veriore dhe Nekropolit Verior, ku sic duket kemi



Arkeo-terren

Shkurte Gashi dhe Blerta Abazi, studente të arkeologjisë



Padyshim, gërmimet arkeologjike janë ndër eksperiencat më të bukura që studentët e arkeologjisë përfitojnë gjatë studimeve në Departamentin e Antropologjisë. Ekspeditat arkeologjike janë ato përmes të cilave studentët përveç formimit nga pjesa teorike gjatë ligjeratave në Universitet, thellohen edhe më shumë në fushat e studimit të tyre përmes punës praktike.

Gjatë tre vitëve studim në Departamentin e Antropologjisë, si shumë kolegë tjerë, edhe ne kishim mundësinë të marrim pjesë në projekte të ndryshme arkeologjike si gërmime, survej etj. Në mënyrë që njohuritë tona mos të mbesin të kufizuara në një periudhë të caktuar kohore, ne jemi të lumtura që kishim fatin të gërmojmë në lokalitete të cilat i takojnë periudhave të ndryshme. Pra, jemi njohur për sa afërmi fillimisht me kultura neolitike, pastaj kemi gërmuar në lokalitete të periudhës romake, e për të vazhduar me antikitetin e vonë dhe mesjetën e hershme.

Ne kemi filluar të përfshihemi në projekte të hulumtimeve arkeologjike qysh nga viti i parë

i studimeve. Por, kësaj radhe do veçojmë vetëm ekspeditat dhe përvojat e vitit 2021, të cilat njëherit janë edhe të rëndësishmet që kemi përjetuar deri më tani. Gjatë kësaj vere në morëm pjesë në hulumtimet që u zhvilluan në liqenin e Pogradecit, e pastaj dhe në lokalitetin e Komanit, në Veri të Shqipërisë.

Ekspedita në Lin u zhvillua në Liqenin e Pogradecit. Lokaliteti Lin 3 bënë pjesë në vendbanimet e periudhës së neolitit të mesëm. Ky projekt është në partneritet mes Akademinë të Studimeve Albanologjike në Tiranë, Institutit Federal Zviceran të Teknologjisë të Cyrihut (ETHZ), Shoqërisë për Arkeologjinë Nënujore Zvicerane (GSU) dhe Shërbimit Arkeologjik të Kantonit të Bernës (ADB). Në krye të ekipit shqiptar ishte Prof. Adrian Anasatasi, të cilin shfrytëzojmë rastin t'ua falenderojmë përzemërsisht për mundësin e pjesëmarrjes në këtë ekspeditë dhe për mësimet shumë të vyeshe që na i ka dhënë. Kjo ka qenë një eksperiencë e paharruar përmes së cilës mësuam më shumë për material të periudhës së neolitit në veçanti qeramiken e kësaj periudhe

si dhe ndërtimin e vendbanimeve palafite.

Më pas, morëm pjesë në fushatën e gërmimeve arkeologjike të zhvilluara në vendbanimin e mesjetës së hershme në Koman, zona arkeologjike A, si pjesë e misionit shqiptaro-francez të projektit “Lugina e Drinit”, me drejtueset Prof. Etleva Nallbani hulumtuese shkencore në CNRS-Paris dhe Prof. Elvana Metalla nga Instituti Arkeologjik i Tiranës, të cilat i falenderojmë po ashtu për mundësinë dhe ndihmën e tyre në formimin tonë. Gjatë punës në ekspeditë ne u angazhuam në sektorin e nekropolit duke punuar në grup dhe duke u marr me gërmimin e varreve të ndryshme dhe me përgatitjen e dokumentacionit përkatës. Gjithashtu ne punuam edhe në zona të ndryshme: në banesa dhe në kishat e zbuluara tashmë në lokalitet. Trajtuam materialin arkeologjik, mbetjet kockore, qeramikën si dhe gjetjet e ndryshme nga inventari i varreve.

Ne besojmë fuqishëm që njohuritë e përfituara nga këto gërmime na kanë aftësuar edhe më shumë, e do të na hyjnë në punë përgjatë studimeve tona master dhe ekspeditave tjera arkeologjike që mezi presim t'i nismim.

Etnografi - terren

Fatjona Berisha dhe Arbesa Berisha, studente të antropologjisë kulturore



Fragmente shkrimi nga etnografia në terren, e realizuar nga studentët e vitit të dytë të antropologjisë kulturore

Si antropologë të ardhshëm padyshim që dalja në terren, dhe njohja me njerëz të ndryshëm, si për nga mosha ashtu edhe nga profesionet është gjëja jonë më e preferuar.

Vizita në ndërmarrjen “Krusha” së bashku me kolegë dhe profesorë na mësoi shumë të reja, jo vetëm nga puna që këto gra bënin, si kishin arritur deri aty dhe si po rriteshin çdo ditë e më shumë edhe në tregje ndërkombëtare, por patëm mundësinë që të njohim nga afër shumë nga ato gra e nëna, e kur themi nëna flasë për ngrohtësinë, mikpritjen që na dhanë dhe bisedën që zhvilluam së bashku për disa orë.

Fahrije Hoti, është themeluese e Kooperativës Bujqësore “Krusha”, në të cilën janë të punësuar rreth pesëdhjetë gra, shumica e të cilave kanë mbetur të veja nga lufta e fundit në Kosovë. Fahrije Hoti është nënë e

dy fëmijëve dhe njëra nga 200 gratë e Krushës së Madhe që humbën bashkëshortët dhe djemtë gjatë luftës së fundit.

Znj. Fahrije tregon që fillimi i saj si një grua e vejë dhe si nënë e vetme nuk ishte aspak i lehtë, por rrethanat ishin të tilla që e detyruan të gjejë një mënyrë që të mbahet për jetën dhe t’u sigurojë dy fëmijëve të saj një jetë të mirë.

Ku nga një numri u rritë cdoherë e më shumë punëtore që janë edhe sot. Me punën që këto gra bënin në atë kohë nuk ishte fare e lehtë, disa prej tyre thonin që nuk paragjykoreshin, e disa të tjera thonin të kundërtën, por nëse marrim parasysh situatën dhe gjendjen e asaj kohë padyshim që këto gjëra do të ekzistonin. Kur i pyetëm ato se a kishin momente të tilla të shumta, sigurisht që kishin mirëpo ato e ndjenin veten të

përmbushur si nëna ngase përmes kësaj pune i kishin shkolluar fëmijët e tyre.

Ndërsa sa i përket punës së tyre produktet e tyre padyshim që u pëlqyen, e vazhdojnë të kërkojnë cdo ditë e më shumë, jo vetëm në treg kombëtar, por edhe atë ndërkombëtar.

“Për mu nuk është më rëndësi të fitojë më shumë, nëse konsumatori nuk ndahet i kënaqur me produktin”, tha znj. Hoti.

Ato janë shumë të kënaqura për punën që bëjnë, madje e konsiderojnë si një biznes familjar, duke marrë parasysh edhe relacionin që kishin me njëra-tjetrën, atë vend e konsideronin si shtëpi të dytë.

Ky raport thonin se i mban ato shumë të motivuara si për punë por edhe për jetën, sepse në momentet kur menduan se jetët e tyre ishin përmbysur ato e gjetën vetën tek njëra-tjetra dhe vazhduan këtë miqësi deri në ditët e



sotme, ku kalojnë së bashku kohën më të madhe.

Por, mbi të gjitha mësuam nga to se jeta është sfidë në vete, por dëshira për të luftuar e për tu mbajtur në jetë i tejkalon të gjitha. E kjo korporatë ishte e kaluara e tashmja dhe e ardhmja e tyre, ku përfaqëson secilën nga to në mënyrën e vet. E kjo arritje e madhe e korporatës është meritë e të gjitha grave të Krushës.

Hasi Jehon

“Hasi jehon” është festival folklorik, që mbahet çdo vit në fshatin Gjonaj, 15 km në veriperëndim të Prizrenit. Rreth 20 ansamble kulturore nga i gjithë vendi mblidhen për të performuar muzikë dhe valle. Në këtë festival kishim fatin që këtë vit në edicionin e 33-të, të ishim pjesë si studentë, duke i’u falënderuar prof. Canollit që na mundësoi pjesmarrjen për tri netë radhazi.

Ishte ky një festival që na mundësoi të mësojmë shumë për kulturën e traditën hasjane, duke qenë afër vendit dhe duke biseduar.

Roli ynë si grup stundryshme që vinin përgatitura nga vetë ata nga anë e mbanë trevat shqiptare.



Nata e parë ishte më një ndjesi shumë e vecantë sepse nisi më sofrën hasjane, ku e dijmë që furra hasjane është shumë e përsosur, e gatesat e shijshme i provuam edhe ne kur shijuam ato të

Pos fotove dhe videove të shumta që realizuam nuk munguan as intervistat që realizuam në forma të ndryshme qoftë më shkrim, më zë apo



edhe më videoincizime, që përveq që na ndihmuan më informacione, po ashtu ndihmuan dhe aspektin e të zhvilluarit një intervist në kushtet tona si pjesmarrës aty.

Këngë, valle e lojëra nga me të ndryshmet shfaqeshin, secila me rendësinë, kuptimin dhe vecantinë e tyre.

Festivali ka një rëndësi shumë të madhe dhe në këtë edicion morën lajmin që ky festival do të jetë një aset në mbrojtje dhe mbështetje të shtetit, lajm ky që ka një peshë më shumë rëndësi për zhvillim dhe vazhdimësi duke ruajtur vlerën që ka si kulturë që shfaqet.

Mirëpo sa i përket promovimit të këtij festivali mendojmë se mund të bëhet shumë më shumë, përmes metodave të ndryshme si rrjetet sociale e po ashtu edhe duke mobilizuar studentë në shpërndarjen e fletushkave nëpër gjithë Kosovën, sepse një festival i tillë meriton të shfaqet me një dimension shumë më të madhë e që do të ishte në interes edhe të diasporës.

Janjeva

Janjeva ndodhet mes kodrave të larta, në lartësinë mbidetare rreth 600 metra, vetëm 12 km nga rruga magjistrale Prishtinë – Ferizaj, 15 km nga qendra komunale – Lipjani dhe 18 km në juglindje të Prishtinës. Është një vendbanim i vjetër, me rrugë të ngushta e shtëpi të vjetra, një larmishmëri të madhe, me një popullsi multietnike si shqiptarë, kroatë, serbë, romë dhe turq.

Në këtë vizitë njëditore patëm mundësi të intervistojmë gra e fëmijë të këtij vendi, ngase burrat thuajse shumica e tyre kishin migruar për të siguruar një jetesë për familjet që kishin lënë prapa, e madje edhe për të marrë familjet me vete.

Një nga gratë që intervistua ishte rrethë moshës 40-vjecare, ajo na foli për jetën e vështirë që kishte bërë, si një nënë me 6 fëmijë, ajo kishte mbetur vetëm me dy të vegjëlit ku vijonin mësimin në gjuhën shqipe në shkollën e vendit, ndërsa të tjerët kishin migruar në Kroaci si shumica më e madhe e këtij vendi, qoftë për të vazhduar shkollimin apo edhe për të gjetur

punë.

Rutina për vajzat ishte thuajse e njejtë me të gjithë të intervistuarat, shkollë-shtëpi, dhe derisa arinin një moshë më të madhe, ato nuk kishin ndonjë aktivitet me të cilin merreshin, dukej sikur bënin një jetë të izoluar. Deri në shkollën e mesme ishte e njejtë gjë, ndërsa pastaj disa vazhdonin tutje duke udhëtuar cdo ditë, e disa e ndalonin shkollën fare për arsye të ndryshme.

Duke qenë se ky vend ishte shumë i pasur me xeherore e me zanate artizanale, ato janë zbehur aq shumë me kohën, sa tani dukej sikur këto nuk kishin ekzistuar asnjëherë më parë. Puna që tani merreshin më shumë ishin blegtoria dhe bujqësia.

Ishte për t'u ardhur keq në fakt se sa të dëshpëruar dukeshin me jetën që bënin, madje edhe fëmiju më i vogël nuk mendonte një të ardhme aty. Shumë shtëpi të braktisura, të vjetra, të bënin të mendosh se a ka pasur me të vërtetë ndonjëherë jetë apo gjallëri në ato vende.

Të ecje nëpër ato rrugë, ishte si të kishim vizituar një pjesë tjetër të botës që jo cdo ditë mund ta hasim, e aq më pak ta jetojmë.



janë të vendosura këto artefakte apo ky muze i krijuar, synohet të ridestinohet apo të përdoret për interesa të tjera jokulturore. Ekziston një mosvetëdijësim i njerëzve për peshën dhe unitetin që bartin ato histori përbrenda tyre.

Duke qenë se ne kishim parë për herë të parë në mënyrë vizuale për shkakë pandemie, vizioni ynë për këtë muze ishte shumë më i ndryshëm nga ai që pamë pasi e vizituam personalisht në këtë objekt shkollor, që po ashtu shfrytëzohej përkohësisht edhe si muze, duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar një objekt adekuat, që plotëson kushtet e një muzeu.

Është për tu ardhur keq sesi një muze aq i pasur është njëkohësisht edhe aq i papërkrahur.

Mitrovica

Muzeu si një institucion i rëndësishëm kulturor është i pasuruar me artefakte që i përkasin asaj kulture ku shfaqet apo dhe vendit ku gjendet.

Ne në qytetin e Mitrovicës vizituam muzeun që për kushtet që përfshinin atë pjesë, ishte mjaft shumë i pasuruar. Ajo që e mbante gjallë atë muze ishte dashuria që stafi kishin për punën dhe kujdesin ndaj këtij objekti që përmbante shumë histori dhe ngjarje shumë me peshë të madhe për vendin. Mënyra

e vendosjes, krononlogjisë dhe demonstrimit në këtë muze ishte shumë unike, poashtu edhe mënyra e të shpjeguarit të ngjarjeve. Nora Prekazi, etnologe dhe kustose në muze, bën një punë më plot vullnet. Ajo shpejgon artefaktet me një narracion mjaft unik.

Mitrovica është një qytet i ndarë që nga ngjarjet e fundit në Kosovë e tutje. Shumë gjëra kanë mbetur peng. Në këtë rast Muzeu është një problem shumë serioz, sepse trajtohet keq nga qeverisjet, pasi që gjithmonë objekti ku

INTERVISTA

Antropologjia kulturore – zgjedhja e shumë të rinjëve nga profile të ndryshme studimore

Nën mbikqyrjen e asistentes Zanita Halimi, studentja Era Brahimaj ka realizuar tri intervista me studentët e vitit të parë të antropologjisë kulturore, të cilet edhe pse kanë diplomuar në fusha tjera studimore, kanë nisur studimet në fushën e antropologjisë kulturore

I. Intervistë me Enis Bytyçin

Era: *Prezentohuni ju lutem emrin, vendlindjen dhe moshën tuaj.*

Enis: Unë jam Enis Bytyçi, i kam 24 vjet (20 Korrik 1998).

Era: *Çka keni studiuar paraprakisht?*

Enis: I kam kryë studimet për drejtësi, tash bëhen dy vite.

Era: *Pse zgjodhët të studioni edhe A\antropologjinë kulturore, pse tash?*

Enis: Nuk e di sa muj' me t' jep përgjigje konkrete për këtë pyetje por unë gjithmonë jom kona i prirë për kulturë, art, gjithçka që e përfshinë me kulturën, kom pas interes për këto çështje gjithë, edhe gjatë studimeve në juridik njëjtë, kom anu gjithmonë te diçka që muj me bo' ma tutje edhe me kulturë, po nuk e kom pa si zgjedhje me studiu diçka tjetër deri mas një viti po i bjen masi kom diplomu. Mendoj se ajo periudha masi ta kryen shkollën e mesme një i ri, është periudhë shumë e rëndësishme me



ditë me vendos se çka po don me studio përnime saktë çka du, po e kom zgjedh juridikun, kom pas qef me zgjedh deri me një pikë. Gjate hulumtimeve e pashë fushën e antropologjise që m'la mbresa dhe ne mes të asaj të vazhdoj studimet master në juridik apo të studioj antropologjinë kulturore, unë zgjedha këtë të dytën meqë e kisha dhe pasion.

Era: *Cilat ish in pritshmëritë tuaja për këtë department dhe a janë arritur?*

Enis: Kam pritë që do të takohem me një grup kolegësh që ndajmë interesa dhe vullnet të njëjtë për studimin e kultures si tërësi, ndërsa fakti që veç se e kam një diplomë mundet me u konsideru edhe si përparësi për mu', mirpo vetem nga ana teknike, pasi që në këtë moment jam në një pozicion të njëjtë sikur edhe kolegët që i kanë studimet për herë të parë tani.

Era: *A ka diçka që ju ka lënë mbresa të papritura ?*

Enis: Në drejtësi e din çka ke me mësu, dhe e meson atë që është e caktuar të mësohet, ndërsa në antropologji është ma e hapur të jep hapësirë ma shumë për studime e për hulumtime për atë që ti ke interesim sipas preferencave që ti ke ose don. Mbresa të papritura më kanë lënë sjelljet e profesorëve që në ditën e parë të prezentimit. Kjo ishte përshtypja e parë pozitive dhe që vazhdon edhe tutje të jetë një relacion shumë i afërt në mesin tonë.

Era: *Sa ju influencon profesioni juaj*

në qasje me antropologjinë?

Enis: Une hala nuk e kom të qarte se si mund t'i inkuadroj këto studime. Njëherë po du me i jep vetes hapësirë me pa ku po qëndroj me antropologji, pastaj mendoj të gjej mënyrën si t'i lidhi këto drejtime dhe me më shërby në të ardhmen. Përveç studimeve është edhe çështja praktike që tani kam më shumë eksperiencë në hulumtim. Ligjëratat në antropologji më kanë bo' me reflektu dhe me u mundu me i marr gjërat në menyre jo të përgjithsme, por më gjithpërfshirëse dhe të respektojmë mënyrën e mendimit të të tjereve në shërbim të krijimit të një mozaiku më kompleks.

Era: Sa jeni të kënaqur me punën që bëni dhe cili do të ishte mesazhi juaj për dike që mendon të filloj studimet në departamentin tonë?

Enisi: Pritja e stafit sidomos e profesorave përveç përgatitjes profesionale është afërsia që e tregojnë me pasion. Ata e kanë transmetu tek unë shpirtin studioz dhe kjo është shumë e rëndësishme për motivim. Unë jam shumë i lumtur që jam në këtë departament dhe i kisha këshillu të gjithë ata që kanë afinitet për kulturë, Departamenti i Antropologjisë kulturore është vend i duhur që të jep hapësirë për thellime e studime ma specifike dhe të jep hapësirë të mjaftueshme edhe pse ndonjëherë është thikë me dy teha, por prap është një risk i mirë që të stimulon edhe ma shumë. Antropologjia të zhvillon shumë natyrën studiuuese ndërsa mua më pëlqen shumë ana akademike e hulumtimit.

Era: Faleminderit shumë për kohën tande.

Enis: Faleminderit juve.

2. Intervistë me Tringa Sefedinin



Era: *Prezentohuni ju lutem emrin, vendlindjen dhe moshën tuaj.*

Tringa: Unë jom Tringa Sefedini, kom lind me 16 Janar 1998 në Prishtinë

Era: *Çka keni studiuar parapra-
isht?*

Tringa: Mbas shkollës t' mesme jom kon' në sociologji në UP një vit, po nuk më ka pëlqy shumë kështu që e kom ndrru, kom shku në dizajn grafik, në Akademinë Evolucion.

Era: *Pse zgjodhët të studioni edhe antropologjinë kulturore, pse tash?*

Tringa: Në antropologji kom dasht' me u regjistru menjëher' mas shkollës së mesme po m' duket që nuk ka pas afat për regjistrim, mas disa viteve mu ka kthy mendimi për antropologji se më ka pëlqy gjithmonë, e kom gjet' veten tu bo hulumtime mbi sjelljet njerëzore dhe çdo gjë që lidhet me antropologji, e shoh veten duke e pas profesion, karrierë jo vetëm si hobi.

Era: *Cilat ishin pritshmëritë tuaja për këtë departament dhe a janë arritur?*

Tringa: Prit'shmëritë e mija janë

të përshtatshme me çka kom arritë, nuk kom pasë ndoni problem me adaptu me stafin ose me landët, m' kanë pëlqy tepër shumë, kur jom regjistru i kom thonë vetit që du me shku me m'suprizu për mos me pasë shumë prit'shmeri, më ka suprizu për të mirë deri tash.

Era: *A ka diçka që ju ka lënë mbresa të papritura?*

Tringa: Para se me ja nisë tamam ligjëratave edhe detyrave kom mendu qe kan me i bo në mënyrë ma akademike, po çka më ka befazu për të mirë osht' që t' lojnë me qenë shumë kreativ gjithashtu, mënyrën qysh ti i interpreton sendet, të japin liri për pikëpamjet e tua edhe qysh ti i sheh çështjet e ndryshme, historike, kulturore apo çfarë do qe i kemi pasë temë. Një send që mu ka dok' e çuditshme është që ndihem shumë ma kreative në fakultet të antropologjisë kulturore se sa në dizajn grafik, ndoshta pse edhe ligjëratat shpesh jon shumë inspiruse edhe të lojn' me mendu jashta kornizave akademike të cilat mu kan dokë shumë serioze njëhere a në fakt munden me qenë shumë te lezetshme.

Era: *Sa ju influencon profesioni juaj në qasje me antropologjinë?*

Tringa: Influencë ka tepër shumë, në fakultetin paraparak jom msu' qysh me e kriju ni' storje në mënyrë vizuele, antropologjia ma ka përforcu ata se çka me tregu në anën tjetër dizajni grafik, m'ka msu mënyrën qysh me e tregu ni storje, edhe besoj që kjo mka dhon' vullet edhe ide se qysh me e dokumentu ni çështje, sidomos që antropologjia e ka fuqinë te interpretimi dhe dokumentimi.

Era: *Sa jeni të kënaqur me punën që bëni, dhe cili do të ishte mesazhi juaj për dikë që mendon të filloj studimet në departamentin tonë?*

Tringa: Jom e knaqun me çka kom arrit' po kurioziteti nuk m'len kurrë vet, definitivisht kom hala shumë sende për me msu, kom nevojë me u formësu si antropologe e ardhshme. Mesazhi që kisha dashtë me e dhon' te t'tjertë është që nese dikush e sheh veten në antropologji duhet me provu, nuk është që muj me fol për t'tjerët edhe nuk m'pëlqen shumë me dhon rekomandime, po tu u bazu prej vetes, i ka kalu prit'shmëritë e mija për mirë, u'a preferoj gjithësecilit që ju intereson me msu për kulturëren, për njerzitet, për trashigiminë, arkeologjinë, është drejtim shumë i mirë, edhe stafi është shumë mirë i organizum, plan-programi përkon tepër me antropologjinë bashkëkohore.

Era: *Faleminderit shumë për kohen tande.*

Tringa: Faleminderit ty.

3. Intervistë me Rilinda Gjonbalajn

Era: *Prezentohuni ju lutem emrin, vendlindjen dhe moshën tuaj.*

Rilinda: Rilinda Gjonbalaj, kam lind' me 01.08.1998 në Vuthaj, Plavë – Gusi.

Era: *Çka keni studiuar parapraakisht?*

Rilinda: E kam krye inxhinjerinë e ambientit në Fakultetin Teknik në Universitetin e Prishtinës. Për momentin i ndjek studimet Master në degën e ndërtimtarisë "Menaxhim dhe teknologji ndërtimore" në UBT, kam fillue me studimet në Antropologji këtë vit, një përvojë pak ma ndryshe e kandshme dhe interesante.

Era: *Pse zgjodhët të studioni edhe antropologjinë kulturore, pse tash?*

Rilinda: Unë tash e 18 vjet merrem me shoqërinë kulturore artistike që është e krahinës tonë SHKA "Maja e Karanfilit" dhe prej aty m'është shtue interes i që unë e kam për kulturën, etnologjinë, dhe historinë shqiptare. Kjo m'ka shty me kqyr për një drejtim në fushën e etnologjisë. Un' e kam shkruar një libër, një monografi pikërisht për Shoqërinë kulturore artistike "Maja e Karanfilit" në të cilën i kam përmbledhë 30 vjet aktivitet, prej ktu më është zgjue ideja me shkruar dhe me ba studime etnografike për vënin tem, për kulturën, për pjesën antropologjike, etnologjike të krahinës tonë, edhe nisun prej ksaj, kam thanë me veten pse mos me shkruar si studiuse e jo si dikush që veç ka mujt me mbledhë material për hobi, taman me ba studime që me i shërbye vetes, familjes dhe komunitetit tonë.

Era: *Cilat ishin pritshmëritë tuaja për këtë departament dhe a janë arritur?*



Rilinda: Në fakt pritshmëritë e mia janë plotsue ma shumë se sa kam pritë, meqenëse unë vi prej Fakultetit Teknik që normalisht është shkencë ekzakte për dalim me antropologjinë kulturore, kam vrejtë dallime të mëdhaja posaçërisht në qasjen e stafit dhe mënyrën se si e përvetsojmë dijen, qasja e profesorave është komplet ndryshe, qasja në literaturë, mënyra si funksionon, si punon 95% është ndrysh' prej antropologjisë. Edhe kur kam ardh' në Fakultet Filozofik fillimisht në antropologji, kam vrejt shumë ndryshime gjithmonë kundrejt Fakultetit ku e kam krye' parapraakisht, munesh' me folë ma lirë, munesh' me dhanë menimin tat', në një farë forme nuk kanë të drejtë me ta gjykue se n fund asht' mnyra se si ti interpreton gjanat'.

Era: *A ka diçka që ju ka lënë mbresa të papritura?*

Rilinda: Mbresa për të mire kam shumë, sidomos për inkurajimin e studentëve, raporti i hapun me studentët dhe ndihma që u ofrojnë për ti shty' përpara që ka stafi akade-

mik në antropologji menoj se asht' çelësi i suksesit t'ktij departamenti, dhe pikërisht kjo t' jep liri për me kën' sa ma' kreativ dhe me marrë inicitiva që me ba' sa ma shumë punë t'mira..

Ni' fakt tjetër shumë i ransishëm asht' se une e kam krye shkollimin fillore dhe të mesëm në Mal të Zi, edhe për shqiptarët nuk është që i ke krejt, 10 faqe në historinë e librave shkollorë qoftë për histori të Shqipnisë, qoftë për histori të popullit shqiptar apo për etnologjinë shqiptare, domethanë m'son diçka krejt tjetër, për dika tjetër, nuk m'son kurgja për veti ose identitetin e kombit tat', edhe nëse na nuk kishim msue për historinë tonë vet, nga libra jashtëshkollorë ose nga prindrit thjeshtë nuk e kishim dit historinë e kombit tonë, e k'tu jam tue m'su për veti, jam tue mësua për popullin tëm', jam tue mësua për historinë tëme, kulturën, traditën, për secilin element të sajë, që po m'ban me dasht edhe ma shumë kët' fakultet.

Era: *Sa ju influencon profesioni juaj në qasje me antropologjinë?*

Rilinda: Si profesione përveç në pjesën arkitekturore, zhvillimit të teknologjisë ndertuese tek civilizimet e hershme nuk kanë ndonjë lidhje tjetër, por muj me thanë që m'ban me i pa senet' në mënyrë ma shkencore, ma ekzakte që besoj se është ma e drejtë. Të ban' që objektivist me i lidhë nga këndvështrime dhe komponentë të ndryshëm, si historike, gjeografike, politike, ekonomike pra mënyren se si faktorë të ndryshëm ndikojnë që në tërsi të kryhet një proces, zinxhiri shkak dhe pasojë t'cilt janë jeta që na e jetojmë në njëfarë mënyre.

Era: *Faleminderit shumë për kohen tande.*

Rilinda: Faleminers ty.



Shkëmbimi studentor përmes Programit ERASMUS+

ARLINDA SHATRI, studente e antropologjisë kulturore dhe përfituese e programit Erasmus+

Unë do ta përshkruaja përvojën time me Erasmus Exchange Student në Universitetin Viadrina në Gjermani si periudhën më interesante dhe më të mirë të shkëmbimit kulturor dhe studentor. Studimi mes shumë studentëve të tjerë nga Polonia, Nigeria, Japonia apo Franca ishte vërtet magjepsës. Pata mundësinë të përshihesha dhe të jetoja mes diversitetit dhe të bëhesha pjesë e shumë historive që kishin rëndësi për të folur, për të mësuar pak nga çdo kulturë, dhe për të mësuar fjalë të reja në gjuhë të reja. Përveç kësaj, pata fatin të jetoja në Frankfurt an der Oder në kufirin Polak.

Arritja nga Frankfurtit Oder në Slubice ishte aq lehtë, sapo do të kaloje urën do ta shihje veten në një pengesë gjuhësore dhe monetare. Dukej si hyrje në një qytet të stilit ballkanik, me disa ngjashmëri në ushqim dhe energji të tillë ballkanike.

Sa i përket vetë Gjermanisë, Berlini ishte qyteti më i bukur që më pushtoi zemrën menjëherë. Me mundësinë për të shkuar në Berlin me 1 orë udhëtim me tren, dhe më e mira ishte se me kartën e studentit mund të udhëtoje falas në trenat rajonale në zonën e Brandenburgut.

Vende të pakufizuara për të parë si muzetë e mëdhenj të Berlinit. Unë pata fatin të shikoja rreth 10 nga më të njohurat dhe disa ekspedita. Si i preferuari im do të jetë Muzeu i Spiunëve, në të cilin teknologjia mori përsipër të zbulojë mënyrat më të çuditshme dhe të rrezikshme të agjentëve dhe shërbimeve sekrete. Kjo do të ishte një



ishin të shkëlqyer për të punuar dhe për të mësuar mënyra të reja për t'u marrë me të kaluarën dhe të ardhmen, ishte e mrekullueshme për të mësuar *netnografinë* e cila është një metodë kërkimore e përdorur për kërkimin dhe vëzhgimin në internet të komuniteteve online dhe kodeve të aksesueshme të ndërmarra prej tyre.

Jam shumë e gëzuar që kisha mundësinë e vëzhgimit dhe pjesëmarrjes në studimet e mia në Viadrina University, i inkurajoj të gjithë studentët e Departamentit të Antropologjisë dhe Sociologjisë për aplikim në këtë program.

akses i shkëlqyeshëm për studentët si ne në Departamentin Antropologjisë pasi kemi folur gjatë për muzetë në vitin e parë të studimeve tona dhe aksesin që inteligjenca artificiale dhe teknologjia ka në të.

Si student i huaj u mirëprita shumë mirë nga stafi i Universitetit Viadrina, ata ishin të gatshëm me çdo kusht të më ndihmonin për çdo gjë të nevojshme. Ishte kënaqësi të ishe përkrah profesorëve të cilët ishin të pasionuar pas mësimdhënies, dhe gjithashtu mësimi të gjërave të reja për Kosovën, veçanërisht në zonat rurale pasi që ata vetëm kishin njohur, por të dëgjuarit nga vetë studentët ishte një histori e re për ta. Lëndët që jepen në universitet lidhen realisht me antropologjinë kulturore dhe sociologjinë. Tema ime e preferuar që u zhvillua dhe pata mundësinë ta ndiqja ishte: kultura-etniciteti-ndërtimi dhe anti-feminizmi në diskursin online, në të cilat lëndë të dy profesorët

Shkëmbimi studentor përmes Programit ERASMUS+

IDILA IBRAHIMI, studente e antropologjisë kulturore dhe përfituese e programit Erasmus+

Dega e Antropologjisë kulturore në Universitetin e Prishtinës është një drejtim shumë i rëndësishëm dhe gjithpërfshirës, i cili nuk kufizon studentët për të ndjekur pëlqimet dhe interesat e tyre personale. Në vend të kësaj, i gërsheton këto dëshira individuale me aftësi akademike duke i motivuar studentët për të gjetë zërin e tyre kritik, individual dhe autentik. Kjo vlerësohet shumë nga studentët, të cilët shpesh herë janë thuajse të zhgënjyer, të mërzhitur dhe të stagnuar nga gjendja dhe struktura institucionale në Kosovë, që limiton përputhjen e interesave personale dhe ato akademike.

Për mua, zëri autentik, mendimi kritik dhe shkathtësitë akademike të gjitha kaluan në një proces transformues gjatë një semestri të studimit në fushën e Sociologjisë dhe Antropologjisë Sociale në Universitetin e Bournemouth, Angli. Ky shkëmbim semestral ende vazhdon të ketë një ndikim tejet të madh te unë, një sfidë dhe eksperiencë që ka përcjellë ngritjen time individuale, akademike dhe profesionale. Si dikush që dëshiron të ketë një rritje shoqërore në Kosovë, kjo ka qenë një nga mënyrat më interesante për të reflektuar dhe observuar sistemin akademik dhe institucional në një shtet krejtë tjetër në krahasim me Kosovën. Më e bukura e gjithë kësaj është se mënyra e të menduarit dhe observimet personale gjatë kohës në një shtet tjetër, shumicën e kohës lidheshin me lëndët dhe ligjëratat të cilat ipeshin në universitet. Ky ka qenë një aspekt shumë



i rëndësishëm dhe i pa harruar, pasi që ka gërshetuar anën subjektive dhe objektive, observimet e mia personale, dhe ato pastaj përcilleshin në debate akademike në lidhje me kulturën, globalizimin, etnografinë, dhe gjithçka ndërmjet.

Është tejet interesante të jeshë e mirëpritur në diskutime dhe shkëmbime të mendimeve në një grup të studentëve dhe profesorëve me prapavijë tjetër akademike. Natyrisht për disa gjithmonë ishte dhe intriguese të njohin më shumë për prapavinë tonë personale si shtetas të Kosovës, sidomos në diskutimet të cilat thekësonin ndarjen e jugut dhe veriut global. Gjithmonë me një mirëkuptim ndaj lidhjes tonë personale si studentë nga një shtet i posalindur dhe me histori të komplikuar në debate antropologjike, që shpesh herë sado që ishte e rëndë, i kishte edhe momentet qesharake dhe të bashkë-kuptueshme që shndërronin

ligjëratat në një ambient interaktiv dhe real, mes njerëzve që kanë sfida dhe brenga të ndryshme në raport me shtetin, ambientin dhe kulturën në kontekste lokale.

Përpos faktit se ky shkëmbim semestral është shoqëruar me ngritje akademike, po ashtu ka ndodhur një ndryshim në mënyrën e të menduarit dhe qasjen paragjyquese ndaj mundësive që nuk janë domosdoshmërisht afatgjate.

Jam tejet me fat dhe falenderuese që kam qenë pjesë e dy gjeneratave shumë të fuqishme të stafit akademik dhe grupit studentorë në Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Bournemouth.

Shpresoj që shumë studentë të tjerë me ndihmën dhe mbështetjen e duhur të kenë guxim, durim dhe kurajo të vazhdojnë të ndjekin dëshirat e tyre përtej limiteve.

Shkëmbimi studentor përmes Programit ERASMUS+

MIRIDONË SYLA, studente e antropologjisë kulturore dhe përfituese e programit Erasmus+

Që nga studimet parauniversitare, para se të filloja studimet e mia në Universitetin e Prishtinës, gjithmonë kam qenë e interesuar të eksploroj më shumë se çfarë ndodhë nëse ne dalim jashtë kornizave tona. Fatmirësisht duke qenë studente në Fakultetin Filozofik në Departamentin e Antropologjisë Kulturore arrita që të plotësoj disa prej pritshmërive të mia akademike.

Gjatë këtyre tri viteve të studimeve unë kam mësuar për shumë gjëra mahnitëse, më janë shtuar kureshtjet ende më shumë rreth dukurive që unë i përjetoj gati çdo ditë. Përveç temave dhe teorive shumë të rëndësishme për diskutim, puna praktike më ka ndihmuar që unë të përgatitem dhe të shoh prej afër një jetë shumë palëshe ende jo shumë e identifikuar. Privilegji më i madh për një student të studimeve kulturore është kur ne përjetojmë dhe jemi pjesë e shumë ngjarjeve kulturore dhe jo vetëm, prej afër.

Duke qenë pjesë e grupit të shkëmbimit nga Universiteti i Prishtinës në Universitetin e Bournemouth në Angli do të mbetet një nga kujtimet dhe eksperiencat më të bukura të studimeve bachelor. Përgjatë kësaj periudhe unë arrita të vizitoj shumë atraksione, të cilat shpeshherë i kemi diskutuar gjatë ligjëratave e që pastaj i shikoja me një pikëpamje ndryshe, u njoftova me sistemin e edukimit universitar, që ka qenë me rëndësi për mua për tu mësuar për të vazhduar me studimet më tutje. Biblioteka do të mbetet gjithashtu vendi me kujtimet më të bukura ku kam kaluar



një kohë të gjatë aty edhe gjatë periudhës më stresuese për mua. Studimi një semestral në Angli, më ndihmoi që së pari unë të realizoja andrrën time fëmijërore dhe të vizitoja qytetin që unë çdoherë e kam menduar si opsionin e parë të studimeve të mia universitare, vizitova Londrën.

Do jem falënderuese për profesoret dhe profesorët në Universitetin e Prishtinës që asnjëherë nuk rreshtin duke na mbështetur iniciativat tona, të gjithë studentëve në përgjithësi, gjithashtu edhe për profesoret në Universitetin e Bournemouth që më kanë ndihmuar të adaptohem sa më mire dhe nuk kanë hezituuar asnjëherë për të përhapur më shumë informata rreth dallimeve kulturore mes dy vendeve.

Departamenti i Antropologjisë Kulturore në Fakultetin Filozofik është një degë e re e studimeve që ndihmon dhe u dhuron mundësinë studentëve të praktikojnë atë që mësojnë dhe të informohen pothuajse me të gjitha sferat sociale e politike të vendeve të ndryshme si brenda dhe jashtë.

Muzetë – mos humbshin kurrë!

Shkurta Avdyli, studente e antropologjisë kulturore

Po të më pyeste dikush para një viti se çfarë mendoja për muzetë, me siguri se do t'i thoja se janë disa objekte me vjetërsira të grumbulluara brenda tyre. Por, po më pyeti sot dikush - kam përgjigje krejtësisht tjetër, sepse i shoh me një sy më ndryshe. Muzetë patjetër që janë objekte, por nuk janë vetëm për të ruajtur gjëra të vjetra dhe shumë të “pakuptimta” për shumë njerëz; në muze ruhen shumë artefakte të cilat për historinë e një kombi janë thesari më i madh, janë lidhja mes të kaluarës dhe të tashmës. Muzetë hapin diapazonin e diturisë së individit, sepse na nxitin të hulumtojmë më shumë për kulturën e historinë njerëzore.

Gjatë studimeve, më kujtohet se kemi shkuar bashkë me kolegë edhe tek Galeria e Arteve për një ekspozitë që do mbetet thellë në memorien time. Ajo ishte një ekspozitë me historitë e fëmijëve që e kishin përjetuar luftën dhe që kanë treguar për përvojat e tyre personale dhe kishin dhuruar nga një objekt që bartte kujtesën e asaj “historie të keqe” si pasqyrë e atij tmerri që e kishin parë me sytë e tyre në vendet e tyre, vende të ndryshme me përjetime të ngjajshme si në Kosovë, Siri, Palestinë, Bosnje dhe Hercegovinë, Ukrainë dhe shumë vende të tjera të gjitha të stërmunduara dhe tjetërsuara nga lufta.

Një vizitë tjetër e kemi bërë edhe në Bibliotekën “Hivzi Sylejmani” ku është vendosur ekspozita “Na ishte një herë që kurrë mos


qoftë më”, kushtuar historisë së fëmijëve të shuar nga lufta e fundit në Kosovë. Edhe pse mendoj se ekspozita nuk do të duhej të ishte fare në atë objekt, përkundër kësaj ishte bërë një punë e mrekulueshme në të, spese jepej pasqyrimi më real i asaj që vërtet ndodhi në Kosovë. Mendoja se është ndonjë ekspozitë e vogël sa për ta shënuar si ngjarje dhe se do hyja dhe do dilja shpejt prej saj. Por, duke vazhduar drejt derës shihja qindra emra të shkruar në mure dhe kur kuptova se ata janë emrat e atyre fëmijëve të vrarë pafajësisht në luftë, historitë e tyre më përcollën emocione shumë të forta. Rrëfimi i një të mbijetuarit është pika kulminante ku unë e ndieja kaq shumë emrin që ja kanë vendosur kësaj ekspozite “Na ishte një herë që kurrë mos qoftë më”. Pas kësaj vazhduam drejtë për në Muzeun e Hekurudhave në Fushë Kosovë, i cili kishte rrëfime dhe mandej artefakte. Ky ishte një muze i mbushur me pjesë të trenave të parë që kishin filluar në Kosovë dhe ndihmën e tyre për qarkullim në atë kohë, gjë për të cilën kemi pasur fare pak informacion se ndodhej diku. Si “muze i vogël” na pajisi me shumë informata të rëndësishme që mund të na duhen në të ardhmen. E vetmja gjë sipas mendimit tim që duhej të ndryshohej në të ishte vendodhja e tij sepse, dukej qartazi se ishte objekt i papërshtatshëm për ruajtjen e atyre mjeteve. Por, nuk duhet harruar se aty mungonte edhe pas-



trimi i thellë dhe pa dyshim se nevojitet edhe regjistrimi i artefakteve dhe kryerja e punëve administrative dhe futja nën mbrojtjen e shtetit ato mjete, që të mos humbisnin dhe të dëmtoheshin në atë vend.

Ndonëse shkurtazi, dhashë një pasqyrë të vogël të vizitave në disa muze në Kosovë. Këto vizita në terren më kanë ndryshuar mendimet e mia për muzetë. Kosova duhet të hap më shumë muze sepse ne kemi çfarë të prezentojmë dhe të tregojmë përmes tyre.

Mos humbshin kurrë muzetë!




Dardanët

nga Luan Përzhita(monografi), 2022,
Akadelia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkologjisë,
Tiranë.

Këtë viti u botua studimi monografik “Dardanët” i autorit Prof. Dr. Luan Përzhita. Libri praqet një kontribut të çmuar për njohjen e ecejakeve secio-plitike, ekonomike dhe kulturore të dardanëve dhe Dardanisë ndër shekuj. Studimi është mbështetur në ndërthurjen e burimeve të shkruara antike, atyre epigrafike si dhe rezultateve të gërmimeve arkeologjike.

Studim shtë reflektim i punës disa vjeçare kërkimore-shkencore të autorit në terren dhe biblioteka shkencore, duke u formësuar kësaj në një studim monografik mbi dardanët dhe Dardanië nga parahistoria deri në mesjetë. Kësaj, studiuesit dhe profesionistët e fushës do të kenë në dispozicion një studim në ambientet e tyre për debate shkencore, kurse studentët dhe mësimdhënësit një monografi të rëndësishme për Dardanië, ku do të mund të gjejnë të sintetizuar me mjaft kujdes të dhëna mbi ecejaket e kësaj hapësire gjeografike që nga parahistoria deri në mesjetë.



Motivet në veshjet popullore të grave të Hasit

(katalog) nga Arbnora Kolgjeraj-Rexhaj (2022)
KnKub Heritage, Prishtinë


Në maj 2022 u botuar katalogu “Motivet në veshjet popullore të grave të Hasit”(2022) i autores Arbnora Kolgjeraj Rexhaj, antropologe dhe edukatore e trashëgimisë kulturore shpirtërore. Arbnorja ka bërë një punë të gjatë në terren dhe ka mbledhur një mori motivesh popullore në veshjet e grave të Hasit, që shquhen nga begatia, larmia e asimetria e motiveve. Katalogu është dokumentim i mirë etnografik, por edhe një galeri e përplotë, që mund të bëhet inspirim për të tjerët në aspektin aplikativ.

Veshjet e grave të Hasit njihen si veshje unike në korpusin e veshjeve të krahinave shqiptare, për arsye të asimetrisë së shfaqur në modele, për tipologjinë por edhe për begatinë e figurave të ndryshme zoomorfe e florale të qëndisura në to. Arbnora Kolgjeraj është ish-studente e Departamentit të Antropologjisë. Studentët mund ta gjejnë katalogun në bibliotekën e Fakultetit Filozofik/UP, për të cilën Arbnora ka dhuruar një sasi sosh.

Arsim Canolli

Rrënjë, Rrugëtime, Rropatje

Interpretime antropologjike



CUNEUS
2022

Rrënjë, rrugëtime, rropatje: interpretime antropologjike

nga Arsim Canolli (2022)

Cuneus, Prishtinë

Në qershor u botua përmbledhja e eseve të profesorit Arsim Canollit “*Rrënjë, rrugëtime, rropatje: interpretime antropologjike*”. Libri synon të ofrojë një interpretim antropologjik të mënyrave se si e kaluara e Kosovës ndikon në të tashmen e saj dhe se si e tashmja ndikon në përfytyrimin e të kaluarës.

Në punimet e përmbledhura në këtë libër ofrohen një interpretim i ndeshrashjeve e ndërliqësive të cilësuar si ndërthuerje e “rrënjëve, rrugëtimeve e rropatjeve” të shumta të kosovarëve në faqetinat e tyre kulturore, sociale e politike.

Libri është një përmbledhje e shkrimeve studimore me fokus në temat si: buka, muzeu, festivali folklorik, migrimi i brendshëm, kujtesa, riti i famullit dhe etnologjia e Kosovës. Autori ka dhuruar një sasi librash për bibliotekën e Fakultetit Filozofik, ku studentët mund ta lexojnë.



Në hijen e njeriut

Jane Goodall

CUNEUS

Në hijen e njeriut

nga Jane Goodall (2022)

Cuneus, Prishtinë, përkthyer nga Arsim Canolli

Jane Goodall njihet si primatologia e cila ka bërë kthesë të madhe në dijen njerëzore mbi botën shtazore, gjegjësisht në njohjen e sjelljes së shimpanzeve në Afrikë, që kur ka shkelur në Parkun Kombëtar Gombi, në Tanzani, në vitin 1960. Vrojtimet e saj të kujdesshme, gjetjet e saj unike, përshkrimi i hollë i sjelljes së shimpanzeve në grupet e tyre, por edhe përshkrimi i jetës së saj dhe grupit të saj në mesin e shimpanzeve, është një rrëfim unik në shkencë.

Secili që dëshiron të dijë më shumë për mënyrën e sjelljes së majmunëve antropoidë, “kushërinjëve” tanë më të afërt në hullinë e evolucionit, duhet ta lexojë këtë libër.



SEMINARI I ANTROPOLOGJISË

Departamenti i Antropologjisë

Fakulteti Filozofik | Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Agjenda për vitin akademik 2022-2023

Tema bosht e Seminarit: Migrimi: Perspektiva antropologjike

27.10.2022

TEMA

Julie Vullnetari, PhD
Universiteti i Southampton

A mund të transferohet dashuria? Ç'kuptim kanë dërgesat (remitencat) në migrimin shqiptar?

24.11.2022

Durim Abdullahu, PhD cand.
Universiteti i Prishtinës

Migrimi i arbërve në Itali (shek. XV-XVI)

22.12.2022

Eli Krasniqi, PhD
Universiteti i Gracit

Lëvizjet dhe lidhjet familjare të popullatës afrikane në Shqipëri dhe Mal të Zi gjatë regjimeve komuniste dhe më pas

26.01.2023

Robert Pichler, PhD
Akademia e Shkencave të Austrisë

Dimensions of the return to Kosovo. Family, gender, and generation

23.02.2023

Guillaume de Méritens de Villeneuve
Ecole française de Rome, PhD

Migration of Roman senators during civil wars 49-31 BC

23.03.2023

Carolin Leutloff-Grandits, PhD
Universiteti Evropian Viadrina, Frankfurt (Oder)

Migrants as entrepreneurs in Kosovo: The role of financial and social remittances across borders

27.04.2023

Elif Becan, PhD
Université de Nanterre

Repatriation or Transfer? The Negotiations behind the 1938 Convention between the Kingdom of Yugoslavia and the Republic of Turkey

25.05.2023

Tahir Latifi, PhD
Universiteti i Prishtinës

Ndikimi i migrimit në strukturën demografike të Kosovës

Vendi: Fakulteti Filozofik, salla nr. 127